
GUSHT 2025
Numri 8

REVISTA
TRANSFORMISTI
Organ i pavarur i Klubit të Transformizmit

Art Filozofi
Kulturë Poezi

STUDIUESI DRITAN ÇOKU RINGJALL ARKITEKTURËN E VJETËR TË BERATIT

SHPENDI TOPOLLAJ




Duke cituar Gëten (Goethe), Johan Peter Ekermani, ai që nuk iu nda atij vitet e fundit të jetës, na thotë se gjeniu kur binte fjala për arkitekturën, e quante atë muzikë e ngrirë. Në vazhdën e këtij përcaktimi shkon mesa duket edhe franko - sviceran i gjithanshëm Le Corbusien, vepra e të cilit plot nëntë vjet më parë u përfshi në listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO - s, që shfaq bindjen se arkitektura na emocionon njësoj si muzika dhe poezia. E kanë konsideruar si të tillë, pasi ashtu sikurse përcakton Ernest Dimnet; "Nga të gjitha artet, arkitektura është ajo që më shumë ndikon shpirtin njerëzor..." Dhe kishte të drejtë; se kujt nuk i ka ndodhur kudo që ka shkuar që mos mahnitet nga veprat e pavdekshme të mjeshtrave të mëdhenj, që falë asaj që bënë, mbetën edhe vetë të pavdekshëm. M`u kujtuan të gjitha këto, teksa lexoja librin - album të mikut tim Dritan Çoku me titullin "Historia dhe arkitektura e banesës Lluci - Velagoshti" në Berat, objekt me rëndësi të veçantë, por që fatkeqësisht nuk ekziston më. Ky autor, tashmë mjaft i njohur në fushën e studimeve të tilla, ku mjafton të kujtojmë punën e tij pasionante rreth Kullave të Sahatit ndër shekuj, në këtë botim të ri të SHB 2M, merret jo vetëm anën shkencore të arkitekturës të kësaj ndërtese, por na jep edhe një panoramë shumë më të gjerë të mjedisit dhe kohës, kur ajo u ndërtua, u banua, u shpall monument kulture, deri sa u fshi nga harta qytetit të tij, për t`ia lënë vendin godinave të reja. Një fjalë goje, të merresh me përshkrime, arsyetime dhe të vërteta rreth asaj që nuk e sheh me sytë e tu. Mendoni sesa kokëçarje dhe pengesa ndesh një autor që guxon t`i hyjë një ndërmarrjeje të tillë. Por ja që studiuesit të palodhur Çoku, nuk i mungon si kultura e përgjithshme dhe ajo profesionale, ashtu edhe vullneti titanik për ta realizuar me sukses atë që ka nisur. Dhe mbi të gjitha, këtij intelektuali të kompletuar, nuk i mungon dashuria e madhe për qytetin dhe atdheun e tij. Ai e di mirë së çfarë vlere ka një gjë e tillë, pasi jo më kot historiani A. L. Rowse kishte mendimin se "Arkitektura mund të konsiderohet si historia e gdhendur në gur". Dhe ne shqiptarët, për disa arsye, më shumë sesa të shkruar, historinë e kemi të gdhendur në gurët e kalave, godinave, objekteve të kultit,

skulpturave, sarkofagëve, terrakotave, kolonadave e pse jo, edhe të atyre ndërtimeve që i ruajnë gjurmët e tyre deri në ditët tona, si fjala vjen Amfiteatri i Durrësit, i Butrintit etj. e deri te mozaikët me të cilët janë shtruar dyshemetë e pallateve të dikurshme. Duke ardhur te qyteti i Beratit, me të tashmen e të cilit ne krenohemi, Dritani në studimin e tij të shoqëruar me ilustrime tepër të sakta, që i ka punuar me aq dashuri falë talentit të tij të spikatur, hedh vështrimin në kohë, duke na dhënë edhe përshtypjet e udhëtarit Evlia Çelebiu, i cili kur e vizitoi këtë qytet nga më të rëndësishmit, në 1670 - 1671, na dëshmon se ai kishte mbi 5000 shtëpi të ndara në 30 lagje, dhe rreth 170 hamame për higjienë. Dhe këtu nuk ishte çudia vetëm te vendosja e shtëpive në atë faqe kodre që i dha emrin "Qyteti i njëmbinjë dritareve", por edhe te fakti se me sa finesë dhe utilitarizëm


GUSHT 2025
Numri 8

REVISTA
TRANSFORMISTI
Organ i pavarur i Klubit të Transformizmit

Art Filozofi
Kulturë Poezi



ishin ngritur ato, dhe çfarë mjeshtrash ishin ndërtuesit shqiptarë që në kohë të ndryshme, thirreshin edhe nga treva të tjera të vendit. Autori shkruan në libër: "Banesa beratase paraqitet me një larmi shumë të pasur zgjidhjesh brenda një repertori pak a shumë të tipizuar programesh, të cilat pasqyrojnë shkallën e diferencimit shoqëror brenda kuadrit të bashkësisë qytetare të kohës". Natyrisht që në këtë larmi ndërtimesh, koha, politikat, tërmetet, djegiet, si ajo shtëpia e Babë Dudë Karbunarës, luftrat, shpesh edhe injoranca, nuk kanë arritur t`i ruajnë ato banesa karakteristike, dëshmi edhe e nivelit të jetesës, shijeve estetike të pronarëve apo dhe e kulturës së popullit në përgjithësi. Veç është për të ardhur keq kur lexon në libër se "Periudha e tretë (1945 - 1990), përkon me prishjen më të madhe të kësaj pasurie ndërtimore. Regjimi komunist, që u vendos pas çlirimit, si një akt hakmarrës dhe të pakuptimtë, qysh në vitet e para fillon me prishjen e një pjese të kompleksit të madh të pashait të Beratit". Mesa duket, sipas tyre, në atë shtëpi me aq vlera arkitektonike, nuk duhet të banonte aso kohe një pasha, por sekretari i Parë i Komitetit të Partisë së Beratit. Nga ana e tij, Dritani na i jep të gjitha objektet që ju vu kazma ndër vite, dhe ato nuk janë pak, por plot 48 të tilla, nga të cilat 33 janë nga barbaria e periudhës së komunizmit. Por rindërtimi i tyre nëpërmjet studimeve të tilla, duke i nxjerrë nga pusi i harresës, sikurse thekson në parathënien e tij, arkitekti Andi Papastefani, është një kontribut i vyer edhe në historiografinë tonë. Është e kuptueshme se autori ndalet më gjatë te historiku dhe përshkrimi i banesës Lluci - Velagoshti. Ishin dy shtëpi karakteristike te rruga e Muzakies (Myzeqesë), që i kishin vëllezërit Lluci, Abdurrahmani i cili ia shiti Haki Miloshtit dhe Hamiti i cili në vitin 1951 ja shiti Hilmi Velagoshtit. Mendohet, sipas dëshmive se ndërtimi i tyre daton nga gjysma e parë e shek XVIII - të dhe rikonstruksionet janë kryer në vitet respektive, 1835, 1944 dhe 1956. Duke parë vlerat e mëdha të saj, në vitin 1961 u shpall monument kulture i kategorisë së parë, por kjo nuk zgjati shumë, pasi pas pak viteve, u shkatërrua gati arbitrarisht. Dritani, na jep me hollësi jo vetëm planimetrinë e ndërtesës, pra tipologjinë e saj dhe morfologjinë e elementeve arkitektonike, por edhe plot imtësi dekorimesh si në tavane, dyer, portat e jashtme që ishin dy të tilla, hajatin, katoin, pusin, divanin, korridorin, shëpinë e zjarrit (dhoma e zjarrit për gatim), oxhaqet, ambjentet e banimit, dhomën e miqve ku binte në sy kompleksi musandër, dritare, sergjenë e kamare dhe materialet e çatisë deri dhe tre tymtarët. Vizionari i madh me famë botërore Oscar Niemeyer, ai që i dha jetë ëndrrës së tij arkitekturore për ta bërë Brazilian, kryeqytet, ka thënë një herë se "Arkitektura mund të ketë një funksion politik, pikërisht sepse merret me njeriun dhe mënyrën e tij të jetesës". Kështu shpjegohet edhe ndryshimi i ndërtesës në fjalë, nga ndërtesë me çardak në vitin 1835 në ndërtesë të mbyllur, pasi (dhe ai i referohet Genc Saminit): këto ndryshime "...duhen shpjeguar me largimin përherë e më tepër nga ekonomia bujqësore, e cila gjatë shek. XIX, siç duket, nuk zinte një vend me rëndësi në jetën ekonomike të qytetit". Dhe pikërisht këto ndryshime social - politiko - ekonomike, sollën atë shkatërrimin e atyre vlerave të papërsëritshme arkitektonike gjatë viteve të komunizmit. Ja pse nuk vonon edhe revolta e autorit: "Me sa duket në çdo kohë sistemet, institucionet dhe drejtuesit e tyre, nuk kanë arritur ende të kuptojnë se zhvillimi urban nuk duhet të shoqërohet me zhdukje të kujtesës kolektive dhe të vlerave historiko - kulturore të vendit." Dhe ne e shohim se ky qëndrim i dëmshëm dhe i papërgjegshëm, vihet re edhe sot në demokraci. Prandaj Dritan Çoku gjen rastin të na sjellë në kujtesë thënien e Shekspirit: "Kur synojmë më tepër, shpesh shkatërrojmë atë që është e mirë". Prandaj edhe i palodhuri Dritan Çoku, me studime të tilla për objekte



përfaqsuese si banesa Lluci - Velagoshti, synon t`i rikthejë qyteti muze 2400 vjeçar, me emrat e dikurshëm Antipatrea, Bulheriopolis dhe Beligrad atë bardhësinë që ia cënuan shekujt. Dhe gjithmonë, duke na vërtetuar se arkitektura është jo vetëm emocion, por edhe muzikë e poezi.